

FJALA E DEPUTETIT ENKELEJD ALIBEAJ

E ENJTE 10 SHKURT 2022

Të nderuar qytetarë,

Zonja Kryetare,

Të nderuar deputete,

6 vjet më parë duartrokitjet e kësaj salle për 140 votat lëshuan një jehonë aq të madhe, sa edhe sot në veshët e publikut shqiptar jehojnë ende për një nga reformat e shumëpritura nga publiku shqiptar, por sot, 6 vjet më pas, duartrokitje nuk ka, me sa duket, ajo jehonë është shuar. Ka arsye, madje të forta, të thëna e stërthëna nga ne, opozita, që kapja politike është më se e dukshme; selektiviteti ka shkuar deri në Strasburg; gjykatat bosh i shikojnë qytetarët përditë, tek sa shkojnë atje, sepse gjyqet e tyre fillojnë e nuk mbarojnë kurrë, aq sa kanë detyruar edhe qeverinë ta ribëjë edhe një herë hartën për të mbledhur një grusht gjyqtarësh që kanë mbetur në Tiranë. E, pra, të gjitha këto defekte, të cilat e kanë cenuar reformën në drejtësi, janë në sytë e shqiptarëve. Por do të duhet të themi edhe disa gjëra. Drejtori i RTSH-së, i emëruar nga ai që sot nuk ishte, është në burg; kryebashkiaku i Lushnjës është në burg; dy ministra të qeverisë të këtij, që nuk është sot, janë në burg. Me sa duket, siç thonë italianët: “Non c’è due senza tre”, pritjet i treti. Ky është fakt, është e vërtetë. Në këtë situatë, ku prej 6 vjetësh me të drejtë kemi thënë se reforma e duartrokitur dhe e votuar me 140 vota, filloi mbrapsht që në momentin kur ligjet u miratuan në mënyrë të njëanshme. Kushdo e kuptoi në atë kohë se kush i votoi në mënyrë të njëanshme. Nuk ka sot asnjë fije moraliteti për ta anatemuar qëndrimin e Partisë Demokratike. Çfarë duhet bërë?!

Me të drejtën e Zotit dhe me ndjesinë më të lartë morale, ne të opozitës, që u qëndrojmë të gjitha atyre që kemi thënë deri tani, do të duhej të votonin kundër, së pari, për koherencë morale; do të duhej të votonim kundër, sepse jua kemi thënë e stërthënë, jua kemi parashikuar derexhenë kur reforma në drejtësi dhe vetingu bashkë me të do të kishin përfunduar. Po të ishim thjesht e vetëm individë, po, do të duhej të kishim mbajtur këtë qëndrim, në fakt situata është kjo. Burrëria politike nuk është ajo që i shmangesh kësaj foltore, se më duhet ta them edhe këtë gjë. Një pjesë e madhe e të cilëve deri dje kanë thënë: “Reforma nuk bën, reforma është e dështuar”, me të drejtë sot duhej të kishin dalë këtu e të kishin marrë përgjegjësinë e tyre me votën e tyre “pro” apo “kundër”. Tek e fundit, kjo është përgjegjësia politike, sfida politike e morale që secili nga deputetët duhet të ketë dhe jo të bishtnojnë, siç kanë bishtnuar. Edhe kjo është një çështje tjetër. Publiku na sheh. Analet e historisë janë ato, të cilat do të shkruajnë qëndrimin që ka mbajtur gjithsecili prej nesh sot këtu. Pyetja e madhe për të gjithë ne këtu është: çfarë do të bëjmë në këtë karakatinë, sesi është shndërruar drejtësia, bashkë me të edhe vetingu? A kemi përgjegjësi politike, mbi të gjitha, publike për reformën po e po, por, mbi të gjitha, për shtetformimin?

Këtë menduam ne sot, dje, pardje, gjatë gjithë kësaj kohe kur po diskutohej çështja e zgjatjes së afatit të vetingut. Me të drejtën e Zotit kishim për të votuar kundër; për peshën e përgjegjësisë, karakatinën ku e keni çuar ju, që politikisht keni kapur vetingun dhe institucionet e tjera duhej të votonim kundër, por shërbimi që duhet t’u bëjmë qytetarëve, publikut është ai që duhet të na inspirojë, të na orientojë

dhe vendosëm të votonim pro pa asnjë lloj dridhje qerpiku. E di shumë mirë që sot, nesër, pasnesër, banakët televizivë, media e sponsorizuar, njerëzit do të thonë: “Çfarë bëtë ju? Votuat dhe bashkuat votën, gëlltitët atë që keni thënë në këtë kohë?”. Po të doni, personalisht e pranoj. Mbi të gjitha, është interesi publik, i cili do të duhet të prevalojë, sepse gjithsecili prej nesh gjatë gjithë kësaj kohe kishte disa teste morale për t’i tejkaluar. E para, është marrëdhënia me partnerët tanë, me ata që janë në lozhë, të cilëve ua kemi thënë situatën e keqe ku janë reforma në drejtësi e vetingu, si zbrazja, kapja politike, selektiviteti, njerëz që, me të drejtë, zoti Sulaj tha se i kanë shërbyer drejtësisë me devocion dhe sot janë në shtëpi, ndërkohë që njerëz të korruptuar, të njohur publikisht si gërryes parash, sot vazhdojnë jo vetëm të jenë në sistem, por janë në krye të tij.

E, pra, ky është testi i parë. Përderisa dikur e kemi thënë se kjo është reforma e ndërkombëtarëve, ata të cilët me shumë dashamirësi u ofruan dhe vazhdojnë të ofrohen, ky ishte një detyrim që do të duhet ta bëjmë. Kjo është arsyeja e parë, por jo më kryesorja. Edhe këtu ata kanë peshën e tyre të përgjegjësisë, sepse në këta 6 vjet, sigurisht, klithmat tona në shkretëtirë shumë pak u dëgjuan. E, pra, ja ku jemi sot! Sot kam një thirrje personale për ta: sot dhe për kaq kohë sa do të zgjatë vetingu vëmendja e tyre duhet të jetë shumë herë më tepër e përqendruar; nuk ka më justifikim, nuk ka më alibi. Testi i dytë është lufta ndaj korrupsionit. Thashë pak më parë se drejtues të lartë të administratës, drejtori i televizionit, bashkiakë të PS-së, ministra të PS-së janë në burg. Edhe kjo mund të jetë orkestruar nga ky që rri këtu mbrapa. Sa herë që vjen rreziku tek ai, e kalon te këta. Megjithatë, do të duhet ta shikoj në sensin pozitiv pse një shembull i tillë, derisa të familjarizohet drejtësia e re, e cila është pak e cunguar, ka nevojë për të pasur furka. Po, t’ia japë edhe këtë shans për këta 2 vjet. Ky është shërbimi i dytë, sepse, tek e fundit, lufta ndaj korrupsionit, dhe këtu jemi në të njëjtën linjë dhe në të njëjtën gjatësi vale me ndërkombëtarët, është ajo kryesorja. Ja përse edhe iniciativa jonë për vetingun politik vazhdon e do të qëndrojë; ja përse nuk e bëmë ne atë pazarin politik: “Më jep këtë, të jap këtë!”. Jo, absolutisht jo! Së treti, integrimi, ata, të cilët qëndrojnë në lozhë dhe jo vetëm, por ata, të cilët qëndrojnë në Uashington dhe në Bruksel, kanë thënë: “Do të duhet që Shqipëria të ecë përpara me integrimin”. Një nga kushtet është ky, pa i hequr asnjë lloj presje asaj që thashë në fillim, dhe me kosto për ne; e kuptojmë fare mirë që është edhe me kosto për ne! Në mes të kësaj fushate elektorale i kuptojmë banakët. Ju imagjinoj ju të gjithë nesër, edhe këtë që nuk ishte sot, të filloni e të qesëndisni. Do ta pranojmë edhe këtë, për hir të integritit, për hir të shërbimit që do t’u bëjmë shqiptarëve. Mund të ketë edhe nga ata që mund të thonë: “Jemi të kompleksuar”.

Këtu flas me kolegët e mi dhe nuk kam nevojë të flas e të shikoj asnjërin në sy. Për 6 vjet, ndoshta, ne kemi qenë të kompleksuar! Po, kemi qenë. Me të drejtë zoti Shehu e tha që na ka përndjekur kjo ideja se ne jemi kundër reformës në drejtësi. Nuk kemi qenë asnjëherë kundër reformës në drejtësi; absolutisht! Frika ka qenë e madhe dhe është vërtetuar se reforma në drejtësi, drejtësia do të kapeshin politikisht. Ka ndodhur. Gabimi ynë është që ramë në këtë kurth psikologjik. U shndërruam në sytë jo vetëm të publikut, por edhe të ndërkombëtarëve si pengues. Jo, nuk jemi pengues. Shembulli është ky sot me kosto. Absolutisht me kosto dhe e di që nesër, pasnesër, deri më 6 mars ata, të cilët janë në fushën e betejës, do ta përdorin këtë ndaj nesh. Miqtë e mi, qëndroni me kokën lart. E kuptoj që jeta politike ka vështirësitë e veta, ne kemi vetëm një virtyt në këtë mes, që zor se mund të gjendet sot në arenën politike shqiptare: nuk kemi asgjë për t’u trembur. Kjo është arsyeja kryesore për të cilën sot ne votojmë pro zgjatjes së vetingut. Kjo është arsye e fortë morale. Ky është qëndrimi ynë. Prandaj, absolutisht i kemi të gjitha arsyet, modelet, shembuj, motivin, frymëzimin për t’ua thënë shqiptarëve: këta jemi ne! Ka edhe ca teste të tjera. U aludua diçka këtu për pazare, imoralitet, po e them edhe një herë: kthejuni ligjeve të vitit 2017, atëherë kur vërtet, siç kaloi me konsensus reforma kushtetuese me 140 vota, do të duhej të kalonin edhe ligjet. Analet janë aty dhe mund të shikoni se cilët janë ata që votuan.

Sot nuk ka duartrokitje, jehona e tyre është fikur. Kjo do të duhet të jetë në veshët e kujtdo, të atyre në lozha, këtu poshtë dhe të atyre që na shikojnë. Ky është leksioni më i madh që duhet të marrim për reformën në drejtësi, me të cilën nuk bëhet politikë dhe teka politike. Faleminderit për votat që keni dhënë, kolegët e mi!